




Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Drejtoria e Arsimit

Q/Nr. MM / 01 - 10 219 / 26

Datë, 12.05.2026

Në bazë të Ligjit nr. 04/L- 032 Neni 9, pika 1.1, Neni 10, pika 1,2,4,6 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 09/2023 për regjistrimin e fëmijëve në klasën e parë, Drejtoria për Arsim, shpall:

KONKURS

Për pranimin e fëmijëve në klasën përgatitore/parafillor dhe regjistrimin e fëmijëve në klasën e parë, niveli arsimor 0 dhe 1, në institucionet aftësuëse arsimore publike në Komunën e Kaçanikut.

Në klasën përgatitore/parafillor duhet të pranohen fëmijët që kanë moshën kalendarike 5- 6 vjeç.

Në klasën e parë duhet të regjistrohen fëmijët që e kanë moshën kalendarike 6- 7 vjeç.

Sipas Ligjit të Arsimit Parauniversitar Neni 9, pika 2.6, fëmija i cili në kohën e fillimit të vitit shkollor është nën minimumin e moshës së duhur (5 vite e 9 muaj) për shkollimin e detyruar mund të regjistrohet në këtë shkollim në bazë të rekomandimit të shërbimit profesional pedagogjik-psikologjik.

Vendimi për Pranim/ regjistrim merret nga drejtori i shkollës.

Sipas Ligjit për Arsim Parauniversitar Neni 15, vijimi i shkollimit të detyruar nga ana e nxënësit është përgjegjësi kryesore e prindit.

KUSHT:

Prindi ose kujdestari ligjor është i obliguar që të jetë i pranishëm në pranimin e fëmijës në klasën përgatitore/parafillor dhe regjistrimin e fëmijës në klasën e parë.

DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR PRANIM/REGJISTRIMIN E FËMIUT:

1. Ekstrakti i lindjes

Konkursi është i hapur prej datës **15.05.2026** deri më **15.06.2026**

